



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ . \_\_. 2018

**V E N D I M**

**Nr. 102, Datë 12. 04. 2018**

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me nr.34 Regjistri datë 08.03.2018, e z.A K<sup>1</sup> kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale Korçë<sup>2</sup>, me pretendimin për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar<sup>3</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve.**

Sipas informacionit të sjellë para Komisionerit, z.A. K është prindi i fëmijës G. K, me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me Vendim KMCAP-je. Në ankesën e sjellë pranë Komisionerit, bëhet me dije se fëmija është i regjistruar në klasën e parë dhe ndjek procesin mësimor pranë shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë. Z.K shprehet se përpara dy muajve kanë paraqitur një kërkesë pranë shkollës dhe pranë DAR Korçë, ku kanë kërkuar mësues mbështetës për të birin, G por nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Ai shprehet se mungesa e mësuesit mbështetës, është bërë pengesë dhe ka cënuar ecurinë e djalit në procesin mësimor.

Në përfundim të ankesës, z.K kërkon të ndërmerren masat e nevojshme nga ana e DAR Korçë, lidhur me caktimin e një mësuesi mbështetës, sipas përcaktimeve në Udhëzimin Nr. 38, datë

<sup>1</sup> I Referuar Certifikatës familjare, të Zyrës së Gjendjes Civile Korçë, të datës 06.03.2018, z.A K rezulton të jetë prindi i fëmijës G K.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën DAR Korçë.

<sup>3</sup> Referuar shkresës së datës 16.01.2018 të Repartit të Pedriatisë Speciale, pranë QSUT “Nënë Tereza”, Tiranë, fëmija vuan nga çrregullime të spektrit autik.

07.10.2014 “Kriteret e mësuesit ndihmës dhe për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimoreose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.341/1 prot, date 13.03.2018 ju kërkua informacion: DAR-it Korçë dhe shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë, lidhur me pretendimin e subjektit ankues, z.K<sup>4</sup>.

Me shkresën me nr.199 prot., datë 15.03.2018 Drejtoria Rajonale Arsimore Korçë ka informuar Komisionerin se: “... Pas kontaktit me Komisionin e Vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara ju bëjmë me dije se ky fëmijë është vlerësuar nga Komisioni në vitin 2015, periudhë në të cilën ai frekuentonte kopështin. Në momentin e vlerësimit nga ana e këtij Komisioni fëmija nuk ka patur një vlerësim nga KMCAP, dhe prindit të tij i është rekomanduar realizimi i këtij vlerësimi (KMCAP) me qëllim mundësinë e rishikimit të dytë nga ana e Komisionit. Paralelisht fëmija është ndjekur me plan edukativ individual<sup>5</sup> në kopësht. Nga informacioni i marrë nga shkolla që frekuenton fëmija, ky raport vlerësimi është dorëzuar në muajin Shkurt 2018. Deri në këtë moment Komisioni nuk ka marrë asnjë kërkesë për rivlerësim të fëmijës”.

---

<sup>4</sup> Informacione lidhur me pretendimin për diskriminim ndaj nxënësit G për shkak të aftësisë së kufizuar.

Informacion nëse është ngritur Komisioni Multidisiplinar pranë DAR Korçë, për rastin konkret, si dhe një kopje e procesverbalit të mbajtur.

Informacion nëse është ngritur Komisioni i Vlerësimit pranë shkollës, si dhe një kopje e procesverbalit të mbajtur.

Informacion nëse fëmijës aktualisht i është caktuar mësues mbështetës. Nëse jo, cila është arsyeja.

Informacion nëse për këtë nxënësi është hartuar Program Individual Edukativ i posaçëm. Nëse po, një kopje të këtij PEI-je.

Informacion nëse prindit të fëmijës i është kthyer përgjigje nga ana e Juaj, lidhur me pretendimin e tij, për mësues mbështetës për të birin. Nëse po, një kopje të shkresës.

Informacion lidhur me masat e marra prej Jush, për situatën në fjalë”.

<sup>5</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën PEI.

Theksojmë se nga ana e shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë nuk është sjellë asnjë informacion lidhur me sa është kërkuar nga Komisioneri, megjithëse kanë marrë dijeni që me datë 15.03.2018. (Referuar kuponit postar “Lajmërim marrje”, me kod postar RR 244 966 234 AA).

## **II. Vlerësimi i Komisionerit, i fakteve dhe provave të grumbulluara, gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, analizoi situatën sipërcituar në përputhje me kuadrin e brendshëm ligjor dhe atë ndërkombëtar.

Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit i jep përparësi të dukshme, trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në institucionet arsimore shqiptare.

- E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila po ashtu gëzon një mbrojtje të posaçme nga Konventa e OKB-së “Për të drejtat e PAK”.
- Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për të gjithë organet shtetërore.
- “*Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*”, e ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 108/2012, datë 15 Nëntor 2012, i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuar, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet e kësaj Konvente, ku ofrohet një mbrojtje e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuar, për të siguruar që këto fëmijë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë.

Në këtë kuadër, legjislacioni shqiptar u ngarkon detyra të rëndësishme njësisive arsimore vendore (DAR/ZA) dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëjloj si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe ajo që vlen të theksohet më tepër është prioriteti i këtij legjislacioni për t’i përfshirë dhe integruar ata në institucionet arsimore të zakonshme.

Nën këtë frymë konsiston edhe përmbajtja e nenit 63, pika 2 e ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet: “Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore”.

Megjithatë, për të përcaktuar saktësisht, nëse një fëmijë me aftësi të kufizuara, duhet të ndjekë një institucion arsimor të specializuar apo një shkollë të zakonshme të arsimit bazë, legjislacioni parashikon:

- Në nenin 64, pika 3 i ligjit të sipërpërmendur dhe nenit 93, të Urdhërit nr. 343, datë 19.08.2013, të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencave, parashikohet që: Si detyrim ligjor të njësisë arsimore vendore, pra DAR-it, të krijojë një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar.

Sikurse vihet re, nga parashikimet tepër të detajuara të legjislacionit, DAR Korçë ka detyrime tepër të rëndësishme, lidhur me asistencën dhe kujdesin ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara që mësojnë në institucionet arsimore të qytetit të Korçës. Referuar korrespondencës zyrtare me DAR Korçë, rezulton se:

- Bazuar në proces verbalin e datës 15.03.2018 të Komisionit Multidisiplinar të DAR Korçë, ky Komision i rekomandon drejtorisë së Kopështit nr.12 në Korçë të marrin masa për arsimin e fëmijës Gabriel Kula sipas orientimeve të mëposhtme dhe t’i zbatojnë ato:
  - Të zbatojë legjislacionin në fuqi për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.
  - Të kërkojë mbështetjen e mësuesit asistent për fëmijën, të paktën dy orë në ditë.
  - Të sigurojë arsimin e fëmijës përmes PEI duke ju referuar vlerësimeve të komisionit të DAR.
  - Të bashkëpunojë me aktorë të tjerë për të mundësuar arsim cilësor për fëmijën Gabriel.(sigurimi i mjeteve të nevojshme didaktike, specialistëve të tjerë etj).
  - Të synojë zhvillimin e aftësive sociale, aftësimin për jetën, pavarësinë e tij, etj.

Pra, pretendimin e DAR Korçë se ky raport vlerësimi është dorëzuar në muajin Shkurt 2018, nga ana e shkollës, Komisioneri e vlerëson të pa mbështetur dhe të pa bazuar për faktin se vetë Komisioni Multidisiplinar ngrihet po pranë këtij Institucioni. Pra, DAR Korçë nuk mund të mos ishte në dijeni të një akti të nxjerrë nga një Komision i ngritur pranë tij. Për më tepër, nga ana e DAR Korçë nuk është marrë asnjë masë rregulluese as pas marrjes dijeni nga ana e Komisionerit për problematikën e krijuar me këtë nxënës.

- Nga ana tjetër, neni 65, pika 2, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” parashikon: *“Në institucionet arsimore të zakonshme, programi i personalizuar për nxënësin me aftësi të kufizuara hartohet nga një komision, në përbërje të të cilit janë mësues të fushave të ndryshme të të nxënës të institucionit e psikologë. Hartimi i këtij programi bëhet në bashkëpunim me prindërit e nxënësit. Ndryshimi i programit të personalizuar brenda një institucioni arsimor vendoset nga komisioni brenda institucionit, në bashkëpunim me prindërit e fëmijës”*. Gjithashtu, Urdhëri nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, në pikën 1 të Nenit 95, parashikon shprehimisht: *“I.Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm ngre komisionin për nxënësit me AK, në përbërje të të cilit janë tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënës dhe psikologu/punonjësi social.”*
- Pra, ngritja e një komisioni të tillë është detyrim konkret për drejtuesit e institucioneve arsimore të zakonshme.
- Neni 12, pika 5, e ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” parashikon se: *“ Në fund të periudhës së regjistrimit në shkollat publike, drejtorët e shkollave bazë publike dhe ato private i dërgojnë DAR/ZA-së listat emërore të fëmijëve të regjistruar në shkollat e tyre”*.
- Neni 15, po këtu sanksionon se: *“Drejtori, në bashkëpunim me mësuesit, organizon forma plotësuese për mbarëvajtjen e nxënësve të klasave I-III, si: prindër vullnetarë në rolin e mësuesit ndihmës, mësues ndihmës, ndihmesa e qeverisë së së nxënësve”*.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“ Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Komisioneri konstaton se subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa, shkolla 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, nuk ka paraqitur as parashtrime, as dokumentacionin e kërkuar.

Neni 85 “Mosparaqitja e provave”, në pikën 2 të tij ka parashikuar se: *“Mungesa e përgjigjes ndaj njoftimit mund të merret në konsideratë për qëllimet e të provuarit, në përputhje me rrethanat e çështjes...”*.

- Gjithashtu, referuar parashikimit të nenit 65, pika 3, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nxënësve me aftësi të kufizuara u sigurohen edhe mësues ndihmës dhe shërbim rehabilitues, sipas kriterëve të përcaktuara<sup>6</sup> me udhëzim të ministrit, kjo për t’u siguruar një kujdes akoma edhe më të veçantë, si dhe për të ndihmuar në mbarëvajtjen e tyre në shkollë.

Në nenin 96, pika 2, gërma b) të Urdhërit të sipërpërmendur parashikohet si detyrë e drejtuesit të institucionit arsimor të zakonshëm të nxisë përmirësimin e jetës së nxënësve me AK në mjediset e institucionit arsimor. Dispozita e mësipërme përcakton shprehimisht se Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Këto masa përfshijnë edhe detyrimin e DAR Korçë për mësues ndihmës.

Mirëpo, sikundër rezultoi gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, nuk u vu në dispozicion asnjë dokument a shkresë zyrtare se nga ana e drejtorit të shkollës, të jetë bërë kërkesë me shkrim pranë DAR Korçë, për mësues ndihmës. Gjatë trajtimit të çështjes nuk u siguruan prova që prindi të kishte paraqitur me shkrim një kërkesë të tillë ,siç parashikohet në DN, por një fakt i tillë nuk shlyen nga detyrimi për sigurimin e mësuesit mbështetës as DAR Korçë dhe as shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë, pasi referuar proces verbalit të mbajtur nga Komisioni multidisiplinar i DAR Korçë, ata kanë qenë në dijeni të faktit se fëmija G. K vuan nga çrregullime të spektrit autik, që në periudhën kur ai ishte i regjistruar në arsimin parashkollor, në Kopështin nr12, Korçë.

Pika 4, e nenit 93 të Urdhërit sipërcituar: *“Drejtori i institucionit arsimor këshillohet me komisionin e institucionit arsimor para se t’i drejtohet komisionit pranë DAR/ZA-së dhe bashkëpunon me prindërit e fëmijës për të paraqitur kërkesën e tij”*. Urdhëri nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, në pikën 1 të Nenit 95, parashikon shprehimisht: *“1. Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm ngre komisionin për nxënësit me aftësi të kufizuara, në përbërje*

<sup>6</sup> Sipas normes së përcaktuar nga ministri dhe vlerësimit nga komisioni pranë DAR/ZA-së, në klasat e zakonshme që kanë edhe fëmijë me AK, punojnë mësues ndihmës. Mësuesi ndihmës duhet të ketë diplomën e nivelit arsimor përkatës, të përcaktuar në nenin 57 të LAPU-s, dhe specializim të përshtatshëm në fushën e arsimimit të nxënësve me AK.

të të cilit janë tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënët dhe psikologu/punonjësi social.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se nxënësi G. K, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga sa parashikohet në DN<sup>7</sup> dhe ligjin për Arsimin Parauniversitar, duke mos i ofruar asistencë me mësues ndihmës në procesin e të nxënët në procesin mësimor.

Kjo bën që nxënësi G. K, të mos marrë shërbimin që duhet t'i ofrohet sipas parashikimeve të DN dhe të cënohet në të drejtën e tij për një trajtim sa më dinjitoz, me qëllim integrimin dhe ofrimin e arsimit në përputhje me standartet që kërkojnë aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Këtë frymë kanë ruajtur dhe Ligji “Për arsimin parashkollor” dhe Dispozitat Normative për sistemin arsimor parauniversitar 2013, ku përcaktohen qartë detyrimet e të gjitha strukturave për të garantuar të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar dhe për të garantuar një arsim gjithëpërfshirës.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, 2, 7, 19, 32, pika 1, germa c), nenin 33, pika 10, të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenit 63, pika 2, neni 64, pika 3, neni 65, pikat 2-3, të Ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 93-96 të Urdhërit nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, të nxënësit G. K, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë, duke mos i ofruar asistencë me mësues ndihmës në procesin mësimor të të nxënët.
2. Mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë dhe DAR

<sup>7</sup> Shkurtesë për Dispozitat Normative të arsimit parauniversitar.

Korçë, të marrin masat e menjëhershme, për ofrimin e mësuesit ndihmës në procesin mësimor të të nxënit, për nxënësin G. K.

3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, DAR Korçë dhe Shkolla 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afatit 45 ditor, sipas parashikimit të Kodit të Procedurës Administrative.

**Robert GAJDA**

---

**KOMISIONERI**

(shkaku: aftësia e kufizuar)

(fusha: arsim)